



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës - Kosova Cumhuriyeti	
Republika Kosova - Republic of Kosovo	
Mamuša Belediyesi - Komuna e Mamushës	
Opština Mamuša - Municipality of Mamusa	
Çikës / Çikis - Date / Date	Dalës / Dalës - Izlasht / Izlasht - Outgoing 136-25
No.Nr. No.Nr.	04.08.2025
Tarih/Dt	



Në bazë të paragrafit 6 te nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 63 paragrafi 63.1.1 pika (a) lidhur me paragrafin 62.1 pika d) të Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 30.07.2025 të paraqitur nga Operatori Ekonomik “MEDPLUS” SH.P.K. nga Prishtina, bie këtë :

VENDIM

I

Refuzohet **si e pa bazuar** kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “MEDPLUS” SH.P.K. nga Prishtina e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 30.07.2025 për aktivitetin e prokurimit me numër: **626-24-5207-1-2-1** dhe nr. të brendshëm: **626-24-008-1-2-1** me titull: **“Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar”**

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “MEDPLUS” SH.P.K. nga Prishtina me datë 30.07.2025 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për anulim të procedurës së prokurimit nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: **“Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar”**

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1; 6; 7; 59; 60; 61 dhe 62 të LPP-s si dhe është cekur se janë shkelur dispozitat e neneve 40; 41 dhe 43 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s dhe rregullores, janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim.

Nga pretendimet e O.E. kemi parë që është fakt i pa kontestueshëm që me dt. 29.07.2024 autoriteti kontraktues e ka publikuar njoftimin mbi vendimin e parë, ku në këtë vendim ishte anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se janë bërë lëshime në paramasë. Kundër këtij vendimi O.E. kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt. 02.08.2024, ndërsa AK-ja me dt. 05.08.2024 e kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar.

Gjithashtu është fakt i pa kontestueshëm që pastaj O.E. ka dorëzuar ankesën në OSHP me dt. 14.08.2024, ndërsa në lidhje me ankesën O.E. është nxjerr ekspertiza nga ekspertja shqyrtuese dhe vendimi i panelit shqyrtues me nr. 2024/0735. Në të dy rastet sikurse në ekspertizë edhe në vendim të panelit shqyrtues ankesa e O.E. ishte aprovuar si e bazuar dhe ishte detyruar autoriteti kontraktues që të anuloi vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lëndën ta kthej në rivlerësim.

Në bazë të vendimit të OSHP-s 2024/0735 me datë 15.10.2024 lënda është kthyer në ri-vlerësim të procedurës së prokurimit si dhe është formuar komisioni i ri për ri-vlerësim.

Gjithashtu është fakt i pa kontestueshëm që në lidhje me njoftimin e dt. 04.12.2025 O.E. Medplus SH.P.K. me datë 20.12.2024 kishte paraqitur ankesën Nr. 2024/1244 e cila me vendimin e OSHP-s Nr. 2024/1244 të dt. 07.02.2025 ishte aprovuar si pjesërisht e bazuar dhe lënda është kthyer në rivlerësim, me arsyetimin se Autoriteti Kontraktues nuk kishte hulumtuar tregun edhe përkundër se në shkresat e lëndës ekzistojnë dëshmitë për hulumtimin e tregut nga komisioni rivlerësues, duke u bazuar në nenin 61 të LPP-s dhe Rregulloren për Prokurimin Publik neni 4 paragrafi 4.1 pika c dhe neni 41 Paragrafi 41.4

Fakt i pa kontestueshëm është edhe se O.E. Medplus SH.P.K. me datë 01.04.2025 kishte paraqitur ankesën Nr. 2025/0212 e cila me vendimin e OSHP-s Nr. 2025/0212 të dt. 16.05.2025 ishte aprovuar si pjesërisht e bazuar dhe lënda është kthyer në rivlerësim.

Por pretendimet e O.E. ankues se në të tri rastet, sikurse në ekspertizë edhe në vendime të panelit shqyrtues kinse ankesa e tyre ishte aprovuar si e bazuar janë të pa vërteta, pasi që në të tri rastet ankesa është aprovuar si **pjesërisht e bazuar**, nga OSHP është kërkuar që të merren informata shtesë për shkak që O.E. ankues kishte dorëzuar tender jo normalisht të ulët.

Në pretendimin e parë të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik ankues, është cekur se pasi që autoriteti kontraktues nuk ka mundur të arrij qëllimet e saj për ta anuluar aktivitetin e prokurimit, tani në mënyrë tendencioze po mundohet të na eliminoj nga aktiviteti i prokurimit, me arsye krejtësisht të pa bazuara dhe të paqëndrueshme edhe përkundër faktit që ne jemi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Mirëpo të gjitha vlerësimet kanë treguar diçka tjetër, pasi që për çdo rast që OSHP e ka kthyer lëndën në rivlerësim është formuar komision i ri i vlerësimit të cilët i kanë marrë për bazë rekomandimet e panelit shqyrtues, kanë bërë hulumtime të tregut, kanë analizuar përgjigjet e Operatorit Ekonomik i cili i ka ofruar pas kërkesës së AK-s për sqarimin e tenderit jo normalisht të ulët e në veçanti janë fokusuar në analizën e ekonomisë së procesit të furnizimit, çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme të paraqitura nga O.E. si dhe koston e furnizimeve sikur është kërkuar në nenin 61 të LPP-s dhe Rregulloren për Prokurimin Publik.

Pas analizimit të çmimeve edhe nga komisioni i ri-vlerësimit të tretë, duke u bazuar në nenin 40 paragrafi 40.2.1 të Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, komisioni për rivlerësim për herë të tretë, shqyrtoi përgjigjet e O.E. MEDPLUS SHPK dhe duke u bazuar në nenin 61 të LPP-s, Rregullores për Prokurimin Publik neni 4 paragrafi 4.1 pika c dhe neni 41 Paragrafi 41.4 ka konstatuar që çmimet e ofruara nga O.E MEDPLUS SHPK janë çmime jo normalisht të ulëta për disa pozicione të pjesës së parë dhe për disa pozicione tjera kishte vendosur çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Andaj komision shqyrtoi letrën standarde për sqarimin e tenderit jo normalisht të ulët të datës 12.11.2024 përmes së cilës AK ka kërkuar nga O.E. MEDPLUS SHPK që të na jep sqarim në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta të paraqitura në pozicionet e përshkrimit të çmimit, duke saktësuar ekonominë e procesit të furnizimit, çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicionin e tyre për të kryer furnizimet dhe shërbimet e paraqitura në paramasën për procedurën e prokurimit në fjalë. Gjithashtu kemi kërkuar të na jep informata shtesë mbi koston e furnizimeve dhe shërbimeve të propozuara, pasi që komisioni i ri-vlerësimit duke u bazuar në dispozitat e lartëcekura për tenderët jo-normalisht të ulët, ka konstatuar se O.E. ankues kishte ofruar çmime jo-normalisht të ulëta sipas pozicioneve të përshkruara në çmimore (paramasë), ndërsa në disa artikuj kishte vendosur çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Nga kërkesa për sqarimin e tenderit jo normalisht të ulët është kërkuar nga O.E. Medplus SH.P.K. që të na dërgojnë informatat në lidhje me pozicionet e më poshtme të cilat i kemi ndarë në çmime jo normalisht të ulëta dhe në çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Çmimet jo normalisht të ulëta Lot I:

Pjesa A. Pozicionet: 7, 19, 28 dhe 47.

Çmimet tepër të larta:

Pjesa A. Pozicionet: 14, 15, 18 dhe 23.

Gjithashtu me qëllim të vlerësimit të drejtë të tenderit të O.E. kemi kërkuar që së bashku me informatat të na dërgon referencat në të cilat është bazuar me rastin e vendosjes së çmimeve si dhe si dëshmi të na dërgon **kopje të faturave** së bashku me transfer bankar apo të **kontratave** në të cilat evidentohen artikujt e lartcekur.

Operatori Ekonomik MEDPLUS SHPK me datën 14.11.2024 përmes platformës elektronike ka dorëzuar përgjigjen në kërkesën për sqarim, mirëpo nuk kishte ofruar kurrfarë sqarim në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta të paraqitura në pozicionet e përshkrimit të çmimit. Nuk kishte ofruar informatat e kërkuara duke saktësuar ekonominë e procesit të furnizimit, çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicionin e O.E. për të kryer furnizimet e paraqitura në paramasën për procedurën e prokurimit në fjalë. Por si referencë ka ofruar dy **pro-fatura** në të cilat është bazuar me rastin e vendosjes së çmimeve, mirëpo nuk dërgon tek AK dëshmi të **kopjeve të faturave** së bashku me transfer bankar apo të **kontratave** në të cilat evidentohen artikujt e lartcekur, pasi që pro-fatura është dokument i cili nuk regjistrohet në librat financiar, për këtë arsye nuk ka datë të fiksuar dhe e njëjta, mund të ndryshohet në çdo moment sipas kërkesës së O.E.

Andaj komisioni i rivlerësimit për herë të tretë duke u bazuar në nenin 61 të LPP-s Rregullores për Prokurimin Publik neni 4 paragrafi 4.1 pika c dhe neni 41 Paragrafët 41.8 dhe 41.10 pika b) ka konstatuar që Operatori Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. ka ofruar tender jo normalisht të ulët për pjesën e parë pasi që i ka përmblusur të gjitha kushtet e parapara në nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik për tu cilësuar si tender jo normalisht i ulët. Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura komisioni ri-vlerësues ka rekomanduar që këtij O.E. ti refuzohet tenderi edhe përkundër që ka ofruar tenderin me çmimin më të ulët, sepse nuk ka arritur që të ofroj prova dhe të bind komisionin në lidhje me sqarimin për çmime jo normalisht të ulëta për pjesën e parë, ndërsa për disa artikuj ka ofruar çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Edhe komisioni i tretë për rivlerësim i krijuar pas vendimit të OSHP-s Nr. 2025/0212 të dt. 16.05.2025 gjatë vlerësimit të tenderit për t'i krahasuar çmimet dhe për të vlerësuar tenderin drejtë, duke u bazuar në vendimin e OSHP-s të lartcekur ka hulumtuar tregun në lidhje me artikujt e lartcekur si dhe ka analizuar përgjigjen e O.E. Medplus SH.P.K. në lidhje me tenderin jo normalisht të ulët nga e cila është konstatuar që O.E. kishte ofruar vetëm profaturë dhe nuk kishte ofruar sqarime në lidhje ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara; çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ose origjinalitetin e furnizimeve të propozuara.

Duke i krahasuar çmimet e tregut me çmimet e ofruara nga O.E. Mdeplus SH.P.K. komisioni për rivlerësim, bëri analizën e çmimit dhe vërejtë që në artikujt me nr.7 ASAT GPT – 4x250 ml për një pako kishte ofruar çmimin 2.85 € ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i këtij artikulli sillet prej 22.00 deri në 175.00 euro. Për artikullin me nr. 19. kishte ofruar çmimin 0.42 € për një kuti ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i këtij artikulli sillet prej 5.00 deri në 25.00 euro. Për pajisjen e paraparë në artikullin me nr. 28 Oksigjen koncentrator 5 L kishte ofruar çmimin 1.50 € ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i kësaj pajisje sillet prej 400.00 deri në 800.00 euro. Për artikullin me nr. 47 kishte ofruar çmimin 0.13 € për një kuti ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i këtij artikulli sillet prej 1.0 deri në 10.00 euro. Pra për të gjitha këta artikuj nga komisioni i ri-vlerësimit është konstatuar që janë vendosur çmime jo normalisht të ulëta.

Ndërsa për artikullin me nr. 14. kishte ofruar çmimin 0.06 € për një copë që duke e shumëzuar me 1,000.00 pipeta na jep shumën $1,000.00 \times 0.06 = 60$ € ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i këtij artikulli sillet prej 6.00 deri në 12.00 euro. Për artikullin me nr. 15. kishte ofruar

çmimin 0.07 € për një copë që duke e shumëzuar me 500.00 pipeta na jep shumën: $500.00 \times 0.07 = 35$ € ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i këtij artikulli sillet prej 8.00 deri në 12.00 euro. Për artikullin me nr. 23. kishte ofruar çmimin 0.26 € për një copë që duke e shumëzuar me 25.00 lancet na jep shumën: $25.00 \times 0.26 = 6.5$ € ndërsa në bazë të hulumtimit të tregut çmimi i këtij artikulli sillet prej 2.00 deri në 8.00 euro. Pra për këta artikuj nga komisioni i ri-vlerësimit është konstatuar që janë vendosur çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Sipas rekomandimit të OSHP-s komisioni i rivlerësimit pas hulumtimit të tregut për pjesën e dytë (Lot) 2 të tenderit, duke parë që O.E. edhe për këtë pjesë njëjtë kishte ofruar çmime jo normalisht të ulëta për disa artikuj, ndërsa për artikujt tjerë kishte ofruar çmime tepër të larta, me datë 17.07.2025 ka kërkuar sqarim nga O.E. ankues me ç'rast janë ndarë çmimet jo normalisht të ulëta dhe ato tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Çmimet jo normalisht të ulëta Lot II:

Pjesa A. Pozicionet: 1 , 2 , 3 , 4 , 5 , 6 , dhe 8.

Pjesa C. Pozicioni: 2 .

Çmimet tepër të larta:

Pjesa A. Pozicionet: 10 , 11 , 12 , 14, dhe 16.

Pjesa B. Pozicionet: 1 , 2 , dhe 4.

Pjesa C. Pozicionet: 1 , 3 , dhe 4 .

Me qëllim të vlerësimit të drejtë të tenderit, nga O.E. është kërkuar që së bashku me sqarimin dhe informatat të na dërgon referencat në të cilat jeni bazuar me rastin e vendosjes së çmimeve si dhe si dëshmi të na dërgoni **kopje të faturave së bashku me transfer bankar apo të kontratave në të cilat evidentohen artikujt e lartcekur.**

Me datë 22.07.2025 Autoriteti Kontraktues Komuna e Mamushës, ka pranuar përgjigjen nga O.E. ankues.

Komisioni analizoi dhe shqyrtoi përgjigjen nga O.E. por për shkak se O.E. nuk ka ofruar dokumentet e kërkuara si kopje të faturave së bashku me transfer bankar apo kontrata të realizuara në të cilat evidentohen çmimet e ngjashme, komisioni edhe për pjesën e dytë nuk është bindur që O.E. ka dhënë sqarim të mjaftueshëm, veçanërisht duke saktësuar ekonominë e procesit të furnizimit, çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme të cilat janë në dispozicion të O.E. për të kryer furnizimet si dhe koston e furnizimeve sikur është kërkuar me kërkesë por ka ofruar një profaturë dhe një parakontratë të cilat për komisionin shihet qartë që janë fiktive. Këto dokumente nuk janë të pranueshme pasi që nuk e kanë datën e fiksuar sikur janë faturat dhe transaksioni bankar, por shihet qartë që janë bërë pasi që është paraqitur kërkesa e autoritetit kontraktues, duke kopjuar artikujt nga kërkesa si dhe janë dhënë çmime pak më të ulëta se oferta e O.E. ankues. Gjithashtu edhe “kontrata” e paraqitur nuk mund të merret për bazë pasi që është një parakontratë dhe nuk dëshmon që O.E. e ka realizuar një kontratë të tillë për të bindur komisionin që O.E. ka realizuar kontrata me çmime të ngjashme sikur janë paraqitur në ofertë. Në Udhëzuesin e Prokurimit në nenin 8 paragrafi 8.4 dhe në dosje të tenderit tek kërkesat mbi

mundësitë teknike dhe/ose profesionale është paraparë që si dëshmi do të merren kontratat e realizuara apo të përfunduara dhe jo parakontrat sikur e ka paraqitur O.E. pas kërkesës për sqarimin e tenderit jo normalisht të ulët.

Prandaj duke marrë parasysh se shpjegimi i O.E. nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe bindës, si dhe O.E. nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara **kopjeve të faturave** së bashku me transfer bankar apo të **kontratave** në të cilat evidentohen artikujt për çmimet e ofruara , si dhe duke pasur parasysh se ka ofruar çmime manipulative, tenderi i është refuzuar.

Më poshtë janë bashkangjitur ofertat për artikujt e lartcekur nga të cilat shihen konstatimet e komisionit ri-vlerësues për pjesën e parë.

Nr. I Prokurimit:626-24-5207-1-2-1			
Nr. I brendshëm:626-24-008-1-2-1			
Përshkrimi i çmimit për LOT 1			
FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUESE PER LABORATOR (LOT 1)			
A	FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUESE PER LABORATOR	Njesi	Sasia
7	ASAT GPT -- 4 X250 ml	Kuti	1
14	Vazhduese per pipeta yellow 1/1000 Humana	PAKO	1
15	Vazhduese per pipeta blue 1/500 Humana	PAKO	1
18	Teste per glikometerAccuChekAktiv 1/50	PAKO	1
19	Teste per glikometerAccuCheksenzor 1/50	PAKO	1
23	AccuChek lancets 1/25	PAKO	1
28	Oxygen concentrator 5 L	Copë	1
47	Shpatulla druri jo sterile 1/100	Kuti	1

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	BULIMEDICAL SH.P.K
ADRESA E PLOTE	VETERNIK,MAGJ PRISHTIN-GJILAN
PËRFAQËSUAJ NGA:	
EMRI & MBIEMRI	BURHAN RASHITI
POZITA	DREJTOR
NËNSHKRIMI	
DATA	02.12.2024
VULA	

Te ndëruar, në kuadër të hulumtimit të tregut në lidhje me artikujt e lartcekur, komisioni vlerësoi se oferta e kësaj kompanie është e ulët dhe se ajo është e përdorur për vlerësimin e tenderit me numër dhe shtab të lartcekur.

Nr. I Prokurimit:626-24-5207-1-2-1			
Nr. I brendshëm:626-24-008-1-2-1			
Përshkrimi i çmimit për LOT 1			
FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUESE PER LABORATOR (LOT 1)			
A	FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUESE PER LABORATOR	Njesi	Sasia
7	ASAT GPT -- 4 X250 ml	Kuti	1
14	Vazhduese per pipeta yellow 1/1000 Humana	Copë	1
15	Vazhduese per pipeta blue 1/500 Humana	Copë	1
18	Teste per glikometerAccuChekAktiv 1/50	Copë	1
19	Teste per glikometerAccuCheksenzor 1/50	Kuti	1
23	AccuChek lancets 1/25	Copë	1
28	Oxygen concentrator 5 L	Copë	1
47	Shpatulla druri jo sterile 1/100	Kuti	1

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	Biolab Shpk
ADRESA E PLOTE	Idriz Seferi 295 Gjilan
PËRFAQËSUAJ NGA:	
EMRI & MBIEMRI	Xhelal Demiri
POZITA	Drejtör
NËNSHKRIMI	
DATA	02.12.2024
VULA	

Te ndëruar, në kuadër të hulumtimit të tregut në lidhje me artikujt e lartcekur, komisioni vlerësoi se oferta e kësaj kompanie është e ulët dhe se ajo është e përdorur për vlerësimin e tenderit me numër dhe shtab të lartcekur.

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUŠHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUŠA

FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES PËR LABORATOR DHE MATERIAL DENTAR
PËR QKMF-N

Nr. I Prokurimit: 626-24-5207-1-2-1
Nr. I brendshëm: 626-24-008-1-2-1
Përshkrimi i çmimit për LOT I

FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES PËR LABORATOR (LOT 1)

Identi i artikujt	Emri i artikujt	Specifikimet	Materiali	Shprehja e shtesë	Shprehja e shtesë
7	ASAT GPT – 4 X250 ml	Kull	1	165	
14	Vazhduese per pipeta yellow 1/1000 Human	Copë	1	10	
15	Vazhduese per pipeta blue 1/500 Human	Copë	1	9	
18	Teste per glikometra AccuCheck Aktiv 1/50	Copë	1	8	
19	Teste per glikometra AccuCheck Aktiv 1/50	Kull	1	10	
23	AccuCheck lancets 1/25	Copë	1	8	
28	Oxygen concentrator 5 L	Copë	1	650	
47	Shpatulla duri jo sterile 1/100	Kull	1	1.50	

EMRI I KOMPANISË: **MATKOS PHARM**
ADRESA E PLOTE: **SAHI PRASHERI**
PËRFAQËSUAR NGA: **KASTRIOT VITORA**
EMRI & MBIEMRI: **DEJTOR**
POZITA: **DEJTOR**
NËNSHKRIMI: **[Signature]**
DATA: **04.03.2025**
VULA: **[Stamp]**

Të ndërmarr, në kushte të hapësinës të tregut në të cilën me artikujt e listuar këtu mund të kryhet shërbimi i kësaj që të na japin një shërbim. Oferta do të përdoret për vlerësimin e bërësve me kushte dhe të tjerë.

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUŠHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUŠA

FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES PËR LABORATOR DHE MATERIAL DENTAR
PËR QKMF-N

Nr. I Prokurimit: 626-24-5207-1-2-1
Nr. I brendshëm: 626-24-008-1-2-1
Përshkrimi i çmimit për LOT I

FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES PËR LABORATOR (LOT 1)

Identi i artikujt	Emri i artikujt	Specifikimet	Materiali	Shprehja e shtesë	Shprehja e shtesë
7	ASAT GPT – 4 X250 ml	Kull	1	100 G	
14	Vazhduese per pipeta yellow 1/1000 Human	Copë	1	8 G	
15	Vazhduese per pipeta blue 1/500 Human	Copë	1	8 G	
18	Teste per glikometra AccuCheck Aktiv 1/50	Copë	1	8 G	
19	Teste per glikometra AccuCheck Aktiv 1/50	Kull	1	8 G	
23	AccuCheck lancets 1/25	Copë	1	8 G	
28	Oxygen concentrator 5 L	Copë	1	800 G	
47	Shpatulla duri jo sterile 1/100	Kull	1	1.5 G	

EMRI I KOMPANISË: **MADEROS SH.PK**
ADRESA E PLOTE: **Ura e Fushës**
PËRFAQËSUAR NGA: **Ylli Ahmeti**
EMRI & MBIEMRI: **Ylli Ahmeti**
POZITA: **Manager**
NËNSHKRIMI: **[Signature]**
DATA: **04.03.2025**
VULA: **[Stamp]**

Të ndërmarr, në kushte të hapësinës të tregut në të cilën me artikujt e listuar këtu mund të kryhet shërbimi i kësaj që të na japin një shërbim. Oferta do të përdoret për vlerësimin e bërësve me kushte dhe të tjerë.

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUŠHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUŠA

FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES PËR LABORATOR DHE MATERIAL DENTAR
PËR QKMF-N

Nr. I Prokurimit: 626-24-5207-1-2-1
Nr. I brendshëm: 626-24-008-1-2-1
Përshkrimi i çmimit për LOT I

FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES PËR LABORATOR (LOT 1)

Identi i artikujt	Emri i artikujt	Specifikimet	Materiali	Shprehja e shtesë	Shprehja e shtesë
7	ASAT GPT – 4 X250 ml	Kull	1	170	
14	Vazhduese per pipeta yellow 1/1000 Human	Copë	1	14	
15	Vazhduese per pipeta blue 1/500 Human	Copë	1	10	
18	Teste per glikometra AccuCheck Aktiv 1/50	Copë	1	8	
19	Teste per glikometra AccuCheck Aktiv 1/50	Kull	1	10	
23	AccuCheck lancets 1/25	Copë	1	8	
28	Oxygen concentrator 5 L	Copë	1	650	
47	Shpatulla duri jo sterile 1/100	Kull	1	1.50	

EMRI I KOMPANISË: **Nara Biotics**
ADRESA E PLOTE: **Pr. Sami Frashëri, pr. Bashkim Prëngji**
PËRFAQËSUAR NGA: **[Signature]**
EMRI & MBIEMRI: **[Signature]**
POZITA: **Dejtor**
NËNSHKRIMI: **[Signature]**
DATA: **04.03.2025**
VULA: **[Stamp]**

Të ndërmarr, në kushte të hapësinës të tregut në të cilën me artikujt e listuar këtu mund të kryhet shërbimi i kësaj që të na japin një shërbim. Oferta do të përdoret për vlerësimin e bërësve me kushte dhe të tjerë.

Pra sikur shihet çmimi i ofruar nga O.E. ankues i cili është mbi 200 herë më i ulët se çmimi i tregut, nuk ka si të cilësohet ndryshe pos jo normalisht i ulët. Prandaj edhe ky pretendim është i pa bazuar.

Komisioni për rivlerësim ka analizuar edhe çmimet për pjesën e dytë të tenderit dhe ka konstatuar që edhe për këtë pjesë O.E. ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta për disa artikuj, ndërsa për artikujt tjerë ka vendosur çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Amintet Se Normalizet
te ulita

Oferta = NE Treg

1) 1,37 - 15,00

2) 2,00 - 570,00

3) 2,50 - 176,00

4) 0,70 - 143,00

5) 0,55 - 76,00

6) 0,80 - 6,00

7) 2,40 - 12,00

B

C

2) 0,22 - 2,50

1-Romanian Normalizet
2-Baby kare kare
3-English Tac C

Amintet Se Normalizet
te ulita

Oferta = Treg

O.E.

A

1) 24,00 - 4,60

11) 18,00 - 48,50

12) 30,00 - 35,00

14) 30,00 - 34,00

16) 10,50 - 5,30

B

1) 9,00 - 4,00

2) 4,50 - 1,00

4) 15,00 - 5,30

C

1) 15,00 - 4,00

3) 19,50 - 6,00

4) 45,00 - 17,00

[illegible]

14	Selidid, Permutatsion, Diferentsial i integral polimerizatsiya	Kufi	1	35
15	Khimiya i fizika polimerov	Selid	1	5
16	Novye tipy plastikov	Selid	1	5
17	Plastiki			
18	Plastiki			
19	Plastiki			
20	Plastiki			
21	Plastiki			
22	Plastiki			
23	Plastiki			
24	Plastiki			
25	Plastiki			
26	Plastiki			
27	Plastiki			
28	Plastiki			
29	Plastiki			
30	Plastiki			
31	Plastiki			
32	Plastiki			
33	Plastiki			
34	Plastiki			
35	Plastiki			
36	Plastiki			
37	Plastiki			
38	Plastiki			
39	Plastiki			
40	Plastiki			
41	Plastiki			
42	Plastiki			
43	Plastiki			
44	Plastiki			
45	Plastiki			
46	Plastiki			
47	Plastiki			
48	Plastiki			
49	Plastiki			
50	Plastiki			
51	Plastiki			
52	Plastiki			
53	Plastiki			
54	Plastiki			
55	Plastiki			
56	Plastiki			
57	Plastiki			
58	Plastiki			
59	Plastiki			
60	Plastiki			
61	Plastiki			
62	Plastiki			
63	Plastiki			
64	Plastiki			
65	Plastiki			
66	Plastiki			
67	Plastiki			
68	Plastiki			
69	Plastiki			
70	Plastiki			
71	Plastiki			
72	Plastiki			
73	Plastiki			
74	Plastiki			
75	Plastiki			
76	Plastiki			
77	Plastiki			
78	Plastiki			
79	Plastiki			
80	Plastiki			
81	Plastiki			
82	Plastiki			
83	Plastiki			
84	Plastiki			
85	Plastiki			
86	Plastiki			
87	Plastiki			
88	Plastiki			
89	Plastiki			
90	Plastiki			
91	Plastiki			
92	Plastiki			
93	Plastiki			
94	Plastiki			
95	Plastiki			
96	Plastiki			
97	Plastiki			
98	Plastiki			
99	Plastiki			
100	Plastiki			

NAMA / KOMPANIS ADDRESS & PHONE PERMITS / IJAZAH (MIRI & MIMIMI) POSTAL NAKSIR / KIRI DATA KIRI	KOTA BARU 4 JUNE PERMITS 4 JUNE 2001 DEORAN 18.01.2001
--	--



REPUBLIKA KOSOVË - KOSOVA CUMHURİYETİ
 REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
 JUHA, BELLËSHI - KOMUNA E MAMUŠË
 JUHA, BELLËSHI - MUNICIPALITY OF MAMUŠA

FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES PËR LABORATOR DHE MATERIAL DENTAR
PËR QKMF-N
 Nr. i Prokurimit: 676-24-5207-1-2-1
 Nr. i brendshëm: 676-24-008-1-2-1
 Përshkrimi i çmimit për LOT 2

FURNIZIMI ME MATERIAL DENTAR (LOT 2)

A	Emri i kompanisë	Adresa e plotë	Emri i kompanisë	Adresa e plotë	Çmimi	Çmimi i përcaktuar
1	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	280	1860
2	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	170	
3	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	100	
4	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
5	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
6	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
7	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
8	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
9	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
10	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
11	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
12	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
13	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	

14. Mënyrë për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

15. Mënyrë për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

16. Mënyrë për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

B

1. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

2. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

3. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

4. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

5. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

C

1. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

2. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

3. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

4. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

5. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

EMRI I KOMPANISË
 ADRESA E PLOTË
 PËRQASUESI NJË
 EMRI I ABONENTIT
 PËRQASUESI NJË
 DATA
 JUHA

REPUBLIKA KOSOVË - KOSOVA CUMHURİYETİ
 REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
 JUHA, BELLËSHI - KOMUNA E MAMUŠË
 JUHA, BELLËSHI - MUNICIPALITY OF MAMUŠA

FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES PËR LABORATOR DHE MATERIAL DENTAR
PËR QKMF-N
 Nr. i Prokurimit: 676-24-5207-1-2-1
 Nr. i brendshëm: 676-24-008-1-2-1
 Përshkrimi i çmimit për LOT 2

FURNIZIMI ME MATERIAL DENTAR (LOT 2)

A	Emri i kompanisë	Adresa e plotë	Emri i kompanisë	Adresa e plotë	Çmimi	Çmimi i përcaktuar
1	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	280	1860
2	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	170	
3	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	100	
4	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
5	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
6	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
7	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
8	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
9	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
10	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
11	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
12	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	
13	Leve për anashë 10 cm x 100 mm		Copë	1	80	

14. Mënyrë për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

15. Mënyrë për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

16. Mënyrë për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

B

1. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

2. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

3. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

4. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

5. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

C

1. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

2. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

3. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

4. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

5. Gjatësia 15-40 për ngjyrosje të dhënat që hartojnë cilësia

EMRI I KOMPANISË
 ADRESA E PLOTË
 PËRQASUESI NJË
 EMRI I ABONENTIT
 PËRQASUESI NJË
 DATA
 JUHA



Accu-Chek, Softclix Lancets 25 pieces

Price: \$1.99
SKU: 63-41
Brand: Accu-Chek

[Home](#)
[About Us](#)
[Contact Us](#)
[FAQ](#)
[Privacy Policy](#)
[Terms of Service](#)
[Sitemap](#)

[Home](#)
[About Us](#)
[Contact Us](#)
[FAQ](#)
[Privacy Policy](#)
[Terms of Service](#)
[Sitemap](#)



DeVilbiss Compact 525K5 Stationary Oxygen Concentrator

Price: \$649.00

SKU: 63-41
Brand: DeVilbiss

225

Lion's Dental Supply & Equipment

[Home](#)
[About Us](#)
[Contact Us](#)
[FAQ](#)
[Privacy Policy](#)
[Terms of Service](#)
[Sitemap](#)

Dental Wireless 16:1 Reduction Contra Angle LED Endo Root Canal Motor



Dental Wireless 16:1 Reduction Contra Angle LED Endo Root Canal Motor
 The Wireless 16:1 Reduction Contra Angle LED Endo Root Canal Motor is a compact, lightweight, and portable motor designed for use in root canal treatment. It features a 16:1 reduction ratio, which allows for precise control of the motor's speed and torque. The motor is also equipped with a LED light, which provides excellent illumination of the root canal. The motor is designed to be used with a contra angle, which allows for access to the root canal from a variety of angles. The motor is also designed to be used with a variety of endodontic files, which allows for efficient root canal treatment.

Price: \$219

SKU: 63-41

Product Features:

- 16:1 Reduction Ratio: Provides precise control of the motor's speed and torque.
- LED Light: Provides excellent illumination of the root canal.
- Contra Angle: Allows for access to the root canal from a variety of angles.
- Endodontic Files: Allows for efficient root canal treatment.

Product Description:

The Wireless 16:1 Reduction Contra Angle LED Endo Root Canal Motor is a compact, lightweight, and portable motor designed for use in root canal treatment. It features a 16:1 reduction ratio, which allows for precise control of the motor's speed and torque. The motor is also equipped with a LED light, which provides excellent illumination of the root canal. The motor is designed to be used with a contra angle, which allows for access to the root canal from a variety of angles. The motor is also designed to be used with a variety of endodontic files, which allows for efficient root canal treatment.

Product Specifications:

The Wireless 16:1 Reduction Contra Angle LED Endo Root Canal Motor has a maximum speed of 1600 RPM and a maximum torque of 1.5 Nm. It is designed to be used with a variety of endodontic files, including K-files, H-files, and J-files. The motor is also designed to be used with a variety of contra angles, including 15-degree, 30-degree, and 45-degree.

Product Images:



Product Reviews:

The Wireless 16:1 Reduction Contra Angle LED Endo Root Canal Motor has received excellent reviews from dental professionals. It is praised for its compact size, lightweight design, and precise control of speed and torque. The LED light is also praised for its excellent illumination of the root canal.

Product Availability:

The Wireless 16:1 Reduction Contra Angle LED Endo Root Canal Motor is available for purchase from Lion's Dental Supply & Equipment. It is also available for purchase from other dental supply companies.

Product Contact:

For more information about the Wireless 16:1 Reduction Contra Angle LED Endo Root Canal Motor, please contact Lion's Dental Supply & Equipment at 1-800-555-1234.

Sikur shihet nga AK është kërkuar pajisje të cilat nuk ka mundësi që të furnizohen me çmime tepër të ulëta të cilat i ka ofruar O.E. sepse për disa artikuj të lartcekura ka ofruar çmime deri në dyqind (200) herë më të ulëta se çmimet e tregut. Andaj jemi të sigurt që kudo në botë të merren oferta reale nuk ka mundësi që të bëhen furnizimet me çmimet të cilat i ka ofruar O.E. ankues dhe me të drejtë komisioni i rivlerësimit ka konstatuar që O.E. ka ofruar çmime manipulative.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së, konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë, pasi që ne të gjithë pjesëmarrësit i kemi trajtuar në mënyrë të barabartë pa kurrfarë diskriminimi dhe procedurën e hapur për prokurimin në fjalë e kemi udhëhequr në mënyrë transparente në përputhje të plotë me legjislacionin e prokurimit në fuqi. Gjithashtu të gjitha dokumentet e procedurës janë ngarkuar në platformën e-prokurimi dhe në ueb-faqe të Komunës së Mamushës, andaj është për tu habitur pretendimi i O.E. ankues se procedura nuk është zhvilluar në mënyrë transparente!

Sikur shihet në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ana e O.E. ankues, i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo fakt të vetëm i cili do të dëshmonte shkelje të dispozitave të lartcekura, andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Operatori Ekonomik ankues ka pretenduar se janë shkelur edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së. Edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm, pasi që ne si Autoritet Kontraktues i kemi respektuar të gjitha dispozitat ligjore të legjislacionit të Prokurimit Publik. Për tu siguruar që kjo procedurë të zhvillohet në mënyrën më efikase. Pra qëllimi i LPP-s është që të mbrohet buxheti i shtetit duke siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Republikën e Kosovës. Ndërsa sikur është cekur më lartë O.E. ka ofruar çmime manipulative duke ofruar çmime tepër të ulëta për disa artikuj si dhe duke ofruar çmime tepër të larta në krahasim me ato të çmimit të tregut për disa artikuj tjerë, andaj ne kemi mbrojtur buxhetin e shtetit .

Më tej O.E. ankues pretendon që janë shkelur edhe dispozitat e nenit 59 të LPP-s për shkak që sipas O.E. ankues, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë Çmimi më i ulët me peshim, sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu O.E. ka pretenduar që anulimi është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-s dhe nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Nuk pajtohem që janë shkelur këto dispozita të LPP-së pasi që nuk janë relevante me rastin tonë sepse nuk e kemi rekomanduar për kontratë asnjë Operator Ekonomik por e kemi anuluar tenderin në përshtatje me nenin 43.5 pika b. të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, për shkak se nuk ka pasur tenderues të përgjegjshëm.

Sa i përket dëmeve materiale për të cilat O.E. pretendon se i janë shkaktuar 5,000.00 € edhe këtu O.E. është munduar që të manipuloj pasi që në dosje të tenderit shprehimisht është cekur se AK nuk i mbulon shpenzimet të cilat i bëjnë tenderuesit me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të tenderit të tyre si dhe me rastin e anulimit të procedurës së prokurimit. O.E. ankues ka paraqitur si shpenzim shërbimet e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës si dhe për kërkesën për rishqyrtim

me ç'rast ka deklaruar se ka pasur një dëm enorm pa paraqitur asnjë fakt se si janë shkaktuar këto dëme materiale. Pra edhe ky pretendim është i pa bazuar.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 04.08.2025

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
në Komunën e Mamushës



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.